

VENDIM
Nr.324, datë 30.5.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS TË DISA MJEDISEVE TË NDËRTESES (GODINËS) “ISH-INIMA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”, kati përdhe, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

